



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 598/2 Prot.

Tiranë, më 24 . 02 2023

V E N D I M

Nr. 6 datë 24.02 2023

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të nenit 147/d, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2023, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



Lidhja nr. 1. Plani i inspektimeve për vitin 2023

Nr.	Lloji i inspektimit	Objekti i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Organi i inspektuar	Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si edhe kontroll të raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.03.2023 – 15.09.2023	Gjykatat që do të përzgjidhen, sipas vendimit të inspektimit.	15.09.2023
2.	Tematik	Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.07.2023 – 29.12.2023	Prokuroritë që do të përzgjidhen sipas vendimit të inspektimit.	29.12.2023
3.	Tematik	Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.03.2023 – 15.09.2023	Prokuroritë që do të përzgjidhen, sipas vendimit të inspektimit.	15.09.2023